

VENDIM

Nr. 935, datë 29.12.2014

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2015 PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2015, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e buxhetit për programin e Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2015, sipas tabelave nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



Shtojca nr. 1

PEMA E PROGRAMIT TE ZRPP PER VITIN 2015**Qëllimi i Politikës së Programit**

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepermjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, përditësimin e të dhënave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.


OBJEKTIVAT**OBJEKTIVI 1:** Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme**OBJEKTIVI 2:** Përmirësim përditësimi i të dhënave në ZVRPP**OBJEKTIVI 3:** Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;**OBJEKTIVI 4:** Menaxhimi me efektivitet dhe Sigurimi i Shërbimeve të përgjithshme për të mbështetur një administrim të mirë të ZRPP, nëpërmjet kthimit të përgjigjeve ndaj klientëve të 800 527 kërkesave për shërbime



Tabela nr. 2

Ne 000/ lekë

BUXHETI 2015		
Përshkrimi	Buxheti 2015	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet	1,468,181	
Shpenzime personeli		711,513
Shpenzime korrente		200,640
Investime		526,665
Fondi rezervë (2% e të ardhurave)		29,364
Total	1,468,181	1,468,181
Teprica (1)-(2)		0

Tabela nr. 3

BUXHETI I VITIT 2015

Ne 000/ lekë

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI 2015
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	1,468,181
1	Të ardhura jotatimore	1,468,181
	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1,468,181
I	TOTALI I SHPENZIMEVE	1,468,181
1	Shpenzime personeli	711,513
	Paga	585,119
	Kontribute për sigurime shoqërore	97,138
	Fondi i veçantë i pagave	29,256
2	Shpenzime operative	200,640
	Shpenzime të mirëmbajtjes e të tjera	200,640
3	Shpenzime kapitale, nga të cilat:	526,665
	Investime kapitale të brendshme	526,665
4	Fondi rezervë	29,364
	Fondi rezervë	29,364
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	0